



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Nr. _____prot.

Durrës, më _____.____.2023

Shtojca 11

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

02/05/2023

Drejtuar: [A L B G A R D E N me NIPT K37513520N me adresë: Lezhe, Lagjja "Skenderbeg", godine private 1 kateshe ne superstraden Lezhe - Shkoder, km 1]

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur, Mall

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-62964-03-20-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: FV Gjelberimi ne Qytet

Fondi limit (Sasitë): 29.160.620 (Njëzetë e nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzetë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike/[27 Mars 2023] [Numri: 28]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. AGRO - KORANI me NIPT L13329801V + CURRI me NIPT J67902718S, me vlerë të ofertës 21'875'000 (njëzetë e një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë
2. A L B G A R D E N me NIPT K37513520N, me vlerë të ofertës 28'137'500 (njëzetë e tetë milion e njëqind e tridhjetë shtatë mijë e pesëqind) lekë
3. ULZA me NIPT J67902928O, me vlerë të ofertës 28'787'500 (njëzetë e tetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë
4. BUNA me NIPT J61826501C, pa ofertë ekonomike

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. AGRO - KORANI me NIPT L13329801V + CURRI me NIPT J67902718S, me vlerë të ofertës **21'875'000 lekë**, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit, konstatoi se, operatori ekonomik **AGRO - KORANI + CURRI**:

1. Nuk permbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik, ku citohet se "Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat: Operatori ekonomik duhet paraqese Certifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim per

nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kritereve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative); ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certifikate zyrtare model 3 të aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 të aneksi 4 dhe certifikate origjine të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kritereve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative). Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë furnizimi nga subjekti importues, ku të jetë pajisur me këto dokumenta: Certifikatë Origjine nga shteti importues; Certifikate Fitosanitare nga shteti importues. Varietetet të jenë të regjistruara në katalogun kombëtar shqipëtar”, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se dokumentat e paraqitura nga AGRO - KORANI në permbushje të këtij kriteri, janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me DST, ku në Njoftimin e kontratës, pika 4.7, specifikohet se “Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat është gjuha shqipe”, dhe në vazhdim, në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes/Kualifikimit specifikohet se “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip”.

Në të njëjtën kohë, ky kriter nuk përmbushet as nga subjekti CURRI, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të këtij kriteri, pasi referuar ndarjes së punimeve, ka marrë persiper zerin e preventivit F.V Blir (20 copë).

2. Nuk përmbush piken 2.3.f të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet paraqesë Certifikatën e Regjistrimit për torfen dhe plehun të leshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, pasi subjekti AGRO – KORANI nuk ka paraqitur certifikatën e regjistrimit për torfen. Ky konstatim bazohet në nenin 4 “Perkufizime”, pika 55 e ligjit nr. 17/2020 “Për produktet pleheruese”, ku jepet perkufizimi: 55. “Substrate kultivimi”, janë materialet, përveç tokës ku rriten bimët.

2. ULZA me NIPT J679029280, me vlerë të ofertës **28’787’500 lekë**, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, konstatoi se, operatori ekonomik **ULZA**:

1. Nuk përmbush piken 2.3.a të Kapacitetit Teknik, ku citohet “Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 11’600’000 lekë...”, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur, nuk përmbushet vlera minimale e kërkuar.

2. Nuk përmbush piken 2.3.d të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatorët ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të punësuar për periudhën Nentor 2022– Janar 2023: 1 (një) Agronom të shoqëruar me diplomë, cv, kontrate pune, dhe të jete i pajisur me certifikate nga Ministria e Mjedisit; 1 (një) inxhinier Pyjesh i shoqëruar me diplome, cv, kontrate pune; 1 (një) inxhinier Mjedis i shoqëruar me diplome, cv, kontrate pune dhe të jete i pajisur me certifikate nga Ministria e Mjedisit; 1 (një) Automakinist, i shoqëruar me kontrate pune, dëshminë e aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartele personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT; 1 (një) Eskavatorist i shoqëruar kontrate pune, dëshminë e aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe kartele personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT; 5 (pesë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për “punime në sipërfaqe gjelberta” që vërtetohen me certifikata profesionale, lëshuar nga institucionet e autorizuar me ligj, të shoqëruar me kontrate pune; 10 (dhjetë) punëtorë të thjeshtë, të

shoqëruar me kontrate pune”, pasi ne permbushje te ketij kriteri, referuar formularit permbledhes te vetedeklarimit, nuk eshte deklaruar si pjese e stafit teknik asnje agronom.

3. Nuk permbush piken 2.3.f te Kapacitetit Teknik, ku citohet “*Operatori ekonomik duhet te paraqese certifikatat: Operatori ekonomik duhet paraqese Certificate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe leshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certificate origjinë të lëshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative); ose Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certificate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim per nxjerrjen dhe leshimin e etiketave te furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certificate origjine te leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 per percaktimin e kriterëve te tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative). Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë furnizimi nga subjekti importues, ku të jetë pajisur me këto dokumenta: Çertifikatë Origjine nga shteti importues; Çertifikate Fitosanitare nga shteti importues. Varietetet të jenë të regjistruara në katalogun kombëtar shqipëtar”, pasi nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.*

4. Nuk permbush piken 2.3.e te Kapacitetit Teknik, ku citohet se “*Operatori ekonomik duhet paraqese Çertifikaten e Regjistrimit per torfen dhe plehun te leshuar nga Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural*”, pasi nuk eshte paraqitur asnje dokumentacion ne permbushje te ketij kriteri.

3. BUNA me NIPT J61826501C, pa ofertë ekonomike, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjate shqyrtimit dhe vleresimit te dokumentacionit per permbushjen e kriterëve per kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, konstatoi se, operatori ekonomik **BUNA** nuk ka paraqitur asnje dokument te kerkuar nga Autoriteti Kontraktor.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**A L B G A R D E N me NIPT K37513520N me adresë:Lezhe, Lagjia "Skenderbeg", godine private 1 kateshe ne superstraden Lezhe - Shkoder, km 1**], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 28'137'500 [njëzetë e tetë milion e njëqind e tridhjetë shtatë mijë e pesëqind] lekë /pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [**Bashkia Durres, Njesia e Prokurimit, njesia.prokurimeve@durres.gov.al**] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [**NUK KA TE KLASIFIKUAR TJETER PERVEC KETIJ OPERATORI**], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Emiriana Sako